

FORMULARI NUMËR 3
KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	Ersan
Mbiemri:	Qavolli

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

- **Analizën tuaj;**
- **Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?**

Nga këndvështrimi im, sfidat nëpër të cilat ka kaluar Prokurori i Shtetit, janë të ndryshme duke përfshirë ndërhyrje të vazhdueshme në pavarësinë e sistemit prokurorial dhe krijuar pasiguri te prokurorët, sidomos tendenca për uljen e pagave dhe mos aprovimi i kërkesave për ndarje buxhetore për rritjen e numrit të prokurorëve dhe të tjera. Duke marrë për bazë sfidat e paraqitura në Sistemin prokurorial, sidomos me numrin e vogël të prokurorëve, me theks të veçantë në Departamentin e përgjithshëm dhe Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pavarësisht kësaj mendoj se është shënuar progres në luftën kundër kriminalitetit, rritjen e efikasitetit në trajtimin e çështjeve penale të korrupsionit, krimeve ekonomike, veprat penale kundër integritetit seksual, dhunës në familje, pastrimit të parave, deri te prioritizimi i trajtimit të rasteve të medias duke garantuar kështu edhe lirinë e shprehjes dhe forcuar pavarësinë dhe llogaridhënien. Progres është treguar edhe në çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit ku në vitin 2023 vlera e sekuestruar është rreth 80 milion euro, ndërsa janë konfiskuar rreth 20 milion euro. Në vazhdimësi është punuar në nxjerrjen e rregulloreve dhe udhëzimeve në fusha të ndryshme në kuadër të kompetencave ligjore, me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë dhe ngritjes së efikasitetit, duke siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë për prokurorët në punën e tyre.

- **Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?**

Për të pas një pasqyrë të qartë të gjendjes së Prokurorisë Themelore në Pejë, duhet shikuar për disa vite, prandaj edhe nëse bëjmë një analizë nga viti 2017 e tutje mendoj sa ka ndryshime tejet pozitive. Kjo vie në shprehje duke filluar nga numri i lëndëve të pakryera, numër ky i cili ka rënë për një kohë, aplikimi i procedurave alternative, aplikimi i sekuestrimit dhe konfiskimit dhe të tjera. Prokuroria Themelore në Pejë, kishte 19 prokuror. Me këtë përbërje kjo prokurori kishte ulë jashtëzakonisht shumë numrin e lëndëve të pakryera, madje deri në 315 sosh. Për momentin kur hartohet ky koncept, gjendja me numrin e prokurorëve nuk është e mirë sepse janë vetëm 12 prokuror dhe atë 4 në D.K.R., 2 në D.M. dhe 6 në D.P.

Referuar numrit të madh të gjyqtarëve në D.P. 11 që pranojnë lëndë, krahasuar me numrin aktual të prokurorëve është e vështirë të mbulohen të gjithë gjyqtarët. Kësaj duhet shtuar edhe numrin e lëndëve të pranuar nga viti 2020 - 2023 në këtë prokurori është rreth 12.000 lëndë në regjistrin PP, ndërsa në punë ishin rreth 15.000 lëndë. Në Departamentin e përgjithshëm për këtë periudhë në punë ishin 12,837 lëndë, që

nënkupton se në vit në punë janë mesatarisht rreth 3,200 raste, e që i bie se për vit prokurorët në këtë departament kishin në punë nga rreth 534 lëndë. Numri i lëndëve të pa kryera ndër vite ka filluar të rritet dhe në këtë ka ndikuar numri i prokurorëve. Në vitin 2020 deri në vitin 2023 numri i lëndëve të pa kryera është rritur nga 458 në 1063 ku vetëm në D.P. janë 984 lëndë të pa kryera. Pavarësisht sfidave, puna nuk është ndalur në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës dhe menaxhimit të lëndëve, sidomos luftimin e dukurisë së fajdesë, drogave, korrupsionit, zbatimi i LKZK-së, procedurat alternative dhe të tjera.

- Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Sfidë kryesore aktuale mbetet padyshim numri i vogël i prokurorëve me theks të veçantë në D.P. Sfidë tjetër janë edhe seancat gjyqësore në D.P., ku në mungesë të prokurorëve në këtë departament kanë dështuar një numër i caktuar i seancave gjyqësore. Në këtë drejtim duhet punuar në hartimin e planit *një gjyqtar një prokuror për përfaqësimin*. Sfidë në vete përbënë edhe numri i lëndëve të pa kryera, ku nga viti në vit ky numër është rritur ndjeshëm në 1063 raste dhe pritet të tejkalohet gradualisht me përzgjedhjen e prokurorëve të rinj dhe përkohësisht me angazhimin edhe të prokurorëve nga D.K.R. Regjistri me kryerës të panjohur PPP mendoj se është sfidë tjetër jo vetëm për këtë prokurori por për gjithë sistemin. Edhe pse zbatimi i Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, është aplikuar në këtë prokurori në disa raste, prapë mbetet sfidues aplikimi sa më i shpeshtë i tij.

Një çështje tjetër e cila për një kohë të gjatë e ka karakterizuar këtë rajon janë edhe vrasjet e pas luftës ku deri tani si të pazbuluara janë rreth 110 raste. Një sfidë tjetër janë veprat penale që ndërlidhen me mbrojtjen e ambientit, me theks të veçantë ato të cilat realizojnë të hyra materiale. Nga përvoja si prokuror kam vërejtur se problematike janë edhe produktet farmaceutike dhe ato të mishit. Kjo mendoj se është edhe fenomen i cili i prek qytetarët drejtpërsëdrejti dhe si i tillë duhet trajtuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Në kuadër të kësaj shqetësim janë rritja e veprave penale të ndërtimit pa leje në pjesët e parkut kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", kështu që do të analizohen rastet ku ka aktgjykime të formës së prerë, në mënyrë që të fillohet me rrënimin e objekteve pa leje.

- A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Strategjitë aktuale të sistemit, konsideroj se adresojnë edhe nevojat e Prokurorisë Themelore në Pejë, duke marrë për bazë faktin se sistemi prokurorial ka një plan strategjik 2022-2024, e që adresohen edhe nevojat e prokurorisë për të cilën kam aplikuar për kryeprokuror. Mbështetur në shtyllat e përcaktuara në këtë plan strategjik si: profesionalizmi dhe pavarësia në sistemin prokurorial, efikasiteti dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit, profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve me prioritet, menaxhimi dhe administrimi, integriteti, llogaridhënia dhe etika, si dhe transparencja në sistemin prokurorial, të cilat konsideroj që ndërlidhen edhe me prokurorinë ku kam aplikuar. Të njëjtën gjë e adreson edhe plani i Kryeprokurorit të shtetit për vitin 2024 i cili në kuadër të objektivave trajton edhe disa nga sfidat me të cilat është ballafaquar kjo

prokurori. Po ashtu trajton zvogëlimin e numrit të lëndëve penale, veçanërisht ato me PPP, aplikimin e procedurave alternative, rritja e transparencës, forcimi i besimit të publikut, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe të tjera. Edhe plani vjetor i punës 2024 i KPK-së i trajton nevojat edhe të Prokurorisë Themelore në Pejë, duke përfshirë edhe analizën për rekrutim të prokurorëve.

- **Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

- **Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?**

Vizioni im në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, do të jetë marrja me fenomene konkrete dhe zgjidhja e problemeve. Angazhimi do të fokusohet me qëllim të fuqizimit të rolit të prokurorëve konform detyrave dhe përgjegjësive që i kemi, rritjes së efikasitetit, ngritjes së besimit të publikut dhe do të orientohet në drejtim të bashkëpunimit sa më të ngushtë me prokurorët e kësaj prokurorie, administratorin dhe stafin tjetër, duke përfshirë bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen profesionale për prokuror.

Fokus tjetër do të jet edhe shkrimorja, sepse duke siguruar raportet periodike të punës, do të bëhen edhe analiza konkrete që të merremi me çështje problematike dhe veprat penale të cilat mund të kenë rritje eventuale në mënyrë që të gjejmë zgjidhje konkrete. Në këtë drejtim prokurorët do të kenë përkrahjen maksimale duke u ofruar bashkëpunim në kryerjen e detyrave të tyre, në mënyrë që të kemi rritje të profesionalizmit në çështje hetimore, ngritjes së aktakuzave, ngritjen e nivelit të sekuestrimit dhe konfiskimit, dhe vendime tjera që bien në kompetencë të prokurorit të shtetit. Në periudha periodike do të hartohen orare për përfaqësime për prokurorët në Departamentin e Përgjithshëm. Po ashtu në mënyrë permanente do të kujdesem në lidhje me integritetin, profesionalizmin, llogaridhënien, respektimin e Kodit të etikës për prokurorët dhe stafin tjetër mbështetës.

Planet e punës vjetore do të jenë të harmonizuara me këtë koncept dokument, planet e ZKPSH-së dhe KPK-së dhe të fokusuar në çështje konkrete duke përfshirë veprat penale të caktuara si më poshtë dhe jo vetëm, varësisht prej nevojave që paraqiten.

- **Cilat janë objektivat tuaja kryesore?**

Zhvillimi demokratik i vendit nuk mund të arrihet pa luftën permanente të kriminalitetit me theks të veçantë luftën kundër korrupsionit dhe konfiskimin e pasurisë. Prandaj, vendosja para përgjegjësisë e të gjithë kryesve të veprave penale dhe ndjekja e tyre deri në dënimin meritore duke përfshirë edhe konfiskimin e pasurisë do të jetë synimi ynë parësor.

Objektivat janë të bazuara në fenomene të caktuara, sfida dhe analizim të raporteve konkrete, që si të tilla edhe do të jenë të prekshme, matshme dhe të realizueshme. Si më kryesore në menaxhimin e kësaj prokurorie do të jenë si vijon por jo të kufizuara vetëm në to dhe si të tilla janë të ndara edhe në nën objektiva dhe atë:

- **Rritja e efikasitetit në luftimin e dukurive si në vijim:**
 - o Korruptive, krimeve ekonomike dhe fajdeve;
 - o Trafikimi me qenie njerëzore dhe narkotikëve;
 - o Vepra penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje;
 - o Qarkullimi i produkteve ushqimore dhe farmaceutike;
 - o Mbrojtja e ambientit;
 - o Uzurpimi i pronave publike;
 - o Vrasjet;
 - o Sekuestrimi dhe konfiskimi.
- **Ngritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve dhe forcimi funksional dhe organizativ i Prokurorisë Themelore në Pejë i cili do të përfshijë:**
 - o Menaxhimi efikas i lëndëve, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së prokurorëve;
 - o Procedurat alternative;
 - o Ricaktimi i koordinatorëve për vepra penale të caktuara;
 - o Çështjet që i përkasin sferës organizative të prokurorisë.
- **Transparenca, llogaridhënia dhe besimi i publikut;**
- **Bashkëpunimi ndërinstytucional.**

Në këtë dokument janë përcaktuar disa vepra penale të cilat do të trajtohen me prioritet gjatë punës por duke mos i anashkaluar edhe veprat tjera, varësisht se cilat mund të kenë rritje. Prioritizimi i këtyre veprave penale ndërlidhet me proceset e fuqizimit të sundimit të ligjit dhe avancimin e proceseve të integritetit evropian. Përmes këtyre aktiviteteve synojmë që të ngritet besueshmëria e shoqërisë në Prokurorinë Themelore në Pejë në veçanti në gatishmërinë për të luftuar këto dukuri, por nga ana tjetër edhe të inkurajojmë sa më shumë qytetarët që këto raste t'i paraqesin në prokurori apo polici duke u bindur në paanësinë dhe objektivitetin në trajtimin dhe procedimin e këtyre rasteve. Me qëllim të luftimit efikas të këtyre veprave penale, synojmë fuqizimin e strukturave ekzistuese dhe krijimin e mekanizmave tjerë të nevojshëm, me theks të veçantë ekipeve hetimore brenda prokurorisë. Lidhur me mënyrën e luftimit të këtyre dukurive do të përpilohen dhe plane të veçanta.

Luftimi i dukurive korruptive, pastrimit të parave dhe veprave të tjera të cekura si më sipër, është objektiv i vazhdueshëm i Sistemit prokurorial dhe si i tillë do të jetë edhe për Prokurorinë Themelore në Pejë, ku do të ndërmerren hapa konkret në luftimin e tyre. Në këtë drejtim pres punë konstruktive të koordinatorëve për veprat penale të kësaj natyre. Do të kërkohen raporte periodike lidhur me trajtimin e këtyre rasteve, do të analizohen çdo vit raportet e auditimit dhe të tjera. Në kuadër të këtyre pikave si pjesë e strategjive për luftimin e këtyre dukurive do të jenë:

- Rritja e besimit të qytetarëve në këtë prokurori, në mënyrë që viktimat dhe persona tjerë të paraqesin sa më shumë raste, duke krijuar ambienti të sigurve për viktimën;
- Sigurimi i viktimës tek rastet e dhunës në familje;
- Targimi i individëve dhe grupeve të cilët merren me këto veprimtari;

- Identifikimi dhe kontrollimi i lokaleve ku dyshohet se shitet dhe konsumohen substancat narkotike dhe shfrytëzohen për prostitucion;
- Objektiv i veçantë do të jenë qendrat korrektuese dhe ato të paraburgimit;
- Identifikimi dhe mbyllja e lokaleve të këtij lloji të cilat janë në qendra të banuara apo afër institucioneve arsimore;
- Hetimi i barnatoreve të cilët merren me shitjen e produkteve farmaceutike pa kryer kontrollet përkatëse;
- Hetimi i mishtoreve dhe thertoreve që vejnë në qarkullim produktet e mishit pa kryer kontrolle paraprake;
- Kontrollat e vazhdueshme të gurëthyesve dhe seperacioneve;
- Inicimi i procedurave edhe kundër personave juridik;
- Sekuestrimi dhe konfiskimi edhe i mjeteve të veprës penale;
- Kërkimi i informacioneve lidhur me pronësinë publike, shfrytëzuesit e saj, bazën ligjore dhe të tjera;
- Targimi i rasteve të vrasjeve;
- Inkurajimi i familjarëve dhe dëshmitarëve ekzistues për bashkëpunim në dhënien e informatave për vrasjet;
- Verifikimi i këmbimoreve, duke përfshirë kërkimin e të dhënave për investitorët, sidomos ata në krypto valuta, në bashkëpunim me NJIF, krime kibernetike, hetues etj...; dhe
- Mbajtja e takimeve dhe ligjëratave të përbashkëta me polici dhe pedagog, nëpër shkolla, rreth pasojave që sjellë konsumimi i narkotikëve dhe të tjera.

Sekuestrimi dhe konfiskimi është mjeti më efikas për luftimin e kriminalitetit madje edhe efekti i tij është tejet i madh edhe në parandalimin e kryerjes së veprave penale nga të tjerët. Objektivë i veçantë për këtë prokurori do të jetë zbatimi i procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit përkatësisht pasurisë së specifikuar dhe pajustificuar, e krejt kjo në funksion të konfiskimit përfundimtar. Nga prokurorët do të kërkohet përkushtim më i madh dhe veprim i shpejtë që gjatë procedurës së sekuestrimit e sidomos mundësit që asetet e sekuestruara të shiten sa më shpejtë që është e mundur në mënyrë që të ruhet vlera e tyre, duke aplikuar masat e përkohshme të sigurisë.

Synim i vazhdueshëm do të jetë forcimi i kontrollit sistematik të rasteve të veprave penale që sjellin përfitim pasuror e të cilat rezultojnë me sekuestrim dhe konfiskim. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet rasteve të korrupsionit, fajdeve, degradimit të ambientit dhe të tjera që gjenerojnë të hyra të kundërligjshme, në mënyrën që asnjë rast në të cilin ka përfitim pasuror nuk do të kaloj pa ndërmarrjen e hetimeve financiare, duke aplikuar sa më shumë këto institute me theks të veçantë LKZK-ja. Përkitazi me aplikimin e këtij ligji, do të analizohen aktgjykimet për veprat penale të parapara në nenin 2 të LKZK-së, do të kërkohen informata shtesë përmes NJIF-it dhe në konsultim edhe me zyrën për rikuperimin e aseteve do të iniciohen hetimet për konfiskim. Marrja e këtyre veprimeve nga ana e prokurorëve do të ketë impakt të drejtpërdrejt edhe në vlerësimin e performancës së tyre.

- Ngritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve dhe forcimi funksional dhe organizativ i Prokurorisë Themelore në Pejë:

Organizimi dhe funksionaliteti i administratës ka rol të rëndësishëm në rritjen e performancës së punës për çdo institucion. Në këtë funksion ofrimi i shërbimeve efikase dhe me standarde të kënaqshme profesionale, përmirësimi i komunikimit të brendshëm dhe ngritja profesionale e stafit, do të jenë objektiv i rëndësishëm në menaxhimin e kësaj prokurorie. Duke marrë parasysh se shumë shpejt regjistrat fizik do të hiqen nga përdorimi, një ndër objektivat e kësaj prokurorie do të jetë aftësimi i vazhdueshëm i shkathtësive teknologjike të stafit mbështetës dhe prokurorëve.

Menaxhimi efikas i lëndëve, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së prokurorëve

- Numri i vogël i prokurorëve në Departamentin e Përgjithshëm, ndikon në rritjen e numrit të lëndëve të pakryera e edhe në cilësinë e punës së prokurorëve. Si Kryeprokuror planifikoj krijimin e ekipeve apo task forcave të caktuara me qëllim të uljes së numrit të lëndëve. Këto ekipe do të përfshijnë prokuror, bashkëpunëtor, zyrtar ligjor dhe praktikant. Në këtë drejtim do të angazhohen edhe prokurorët nga DKR, të cilët përpos që do të kryejnë lëndë edhe nga DP, ata edhe do të marrin pjesë në seanca gjyqësore.

Procedurat alternative - Ndryshimet e reja ligjore kanë avancuar në aplikimin e proceduarve alternative, ngase kanë rritur gamën e veprave penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim dhe forma tjera të procedurës alternative. Synimi ynë do të jetë rritja e numrit të rasteve të referimit me procedura alternative, duke u përqendruar në negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe ndërmjetësimin, ngase kohën e fundit kemi pas një rënie të aplikimit të këtyre rasteve ku nga viti 2021 ishin 249 raste që kanë përfunduar me këto procedura, në vitin 2023 ishin 184 raste. Do të synoj që numri i lëndëve të kryera me këto procedura të rritet fillimisht deri 20-25%. Prandaj edhe do të fokusohemi në aplikimin sa më shumë të këtyre instituteve procedurale të cilat mundësojnë qasje më të lehtë në drejtësi, efikasitet, efektivitet dhe ekonomizim të procedurës. Në kuadër të prokurorisë është zyra e veçantë për procedurën e ndërmjetësimin dhe do të vazhdohet trajtimi i rasteve në këtë mënyrë, mirëpo synohet në fuqizimin e komunikimit mes prokurorëve dhe zyrtarit për dërgim të rasteve në ndërmjetësim.

Çështja e koordinatorëve është vlerësuar për të mirë dhe në këtë formë edhe do të vazhdohet, mirëpo synoj që të bëhet riorganizimi në angazhimin e disa prokurorëve për vepra të caktuara penale. Me përzgjedhjen e re që do bëhet, do kërkohet një përkushtim dhe llogaridhënie më e madhe e tyre në punë, duke kërkuar çdo tre muaj të përgatisin raportin e tyre për angazhimet që kanë pas, por edhe për të parë iniciativat e tyre në atë drejtim, për përmirësimin e gjendjes në fushën e caktuar. Angazhimi i tyre do të ndikoj edhe në vlerësimin e performancës, me theks të veçantë rastet me vetiniciativë për dukurinë që janë caktuar.

Çështjet që i përkasin sferës organizative të prokurorisë - Në P.TH. në Pejë, është punuar mjaftë në funksionalitetin e administratës. Në këtë drejtim do të ashpërsohen procedurat e kontrollit për futje brenda prokurorisë për palët, duke përfshirë nga skaneri, kontrolli, regjistrimi deri te dërgimi tek prokurori. Do të rifunksionalizohen

edhe dyert automatike në mënyrën që të kemi evidenca të sakta për prezencën e gjithë stafit në punë, pa anashkaluar edhe prokurorët. Në fund do të funksionalizohen edhe dhomat për të burgosur të cilët sjellën në prokurori dhe hyrja e tyre do të bëhet nga pjesa e poshtme direkt në katet për të cilat janë ftuar, pa pasur mundësi as qasje për t'u parë me palët tjera.

- **Bashkëpunimi ndërinstytucional;**

Komunikimin dhe takimet me institucionet e zbatimit të ligjit, por edhe institucione tjera relevante që ndihmojnë në ndjekjen penale, do të bëjmë përpjekje për fuqizimin e tyre. Puna e përbashkët dhe ekipore, është garancë e një suksesi më të madh. Do të mbahen takimet të rregullta me stafin drejtues të Drejtorisë Rajonale të Policisë, me stacionet përkatëse policore që i mbulon P.TH. në Pejë, takimet e veçanta me drejtorit policore të nivelit qendror. Takimet e rregullta do të mbahen edhe me përfaqësues komunal dhe inspektoratet përkatëse, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit por edhe të marrjes së përgjegjësiive konkrete për dukuri të caktuara. Aktiviteti i bashkëpunimit do të vazhdoj edhe me agjenci të ndryshme, siç janë autoritet pyjore, agjencitë për mbrojtjen e ambientit, NJIF, AKK, ATK-së, AUV-it dhe të tjera. Me këto takime synohet avancimi i bashkëpunimit me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë me qëllim të realizimit të mandatit ligjor.

- **Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?**

Siç u theksua më sipër, sfidë kryesore padyshim do të jetë numri i vogël i prokurorëve në Departamentin e Përgjithshëm, e cila përkohësisht mund të ndikoj në uljen e numrit të lëndëve të pakryera. Gjithashtu sfidë mbetet edhe përfaqësimi në seanca gjyqësore në Departamentin e Përgjithshëm. Një sfidë tjetër është edhe tek rastet e vrasjeve kalimi i kohës së gjatë, vdekja e dëshmitarëve eventual dhe të tjera.

- **Si do t'i tejkalojnë ato?**

Lidhur me numrin e vogël të prokurorëve do të fillohet me parashtrimin e kërkesave konkrete për rritjen e numrit të prokurorëve, duke i arsyetuar ato në detaje, ndërsa sa i përket uljes së numrit të lëndëve të pakryera, në këtë drejtim do të angazhohen edhe prokurorët nga D.K.R., të cilët do të marrin pjesë edhe në seanca gjyqësore, në mënyrë që të mbulohen të gjithë gjyqtarët. Deri në plotësimin e numrit të pozitave për prokuror në D.P., me angazhimin edhe të prokurorëve nga D.K.R. do të synohet një gjyqtar një prokuror. Kjo do të kontribuonte që mos të ketë shtyrje të seancave gjyqësore dhe do t'i shërbente efikasitetit të procedurës gjyqësore.

Lidhur me vrasjet në koordinim me prokurorin bartës të lëndës dhe hetues policor do të rianalizohen të gjitha këto raste, do të bëhet targimi i disa prej tyre dhe do të punohet intenzivisht në identifikimin e kryesve.

- **Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial**

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

- **Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?**

Menaxhimi i brendshëm do të mbështet në ndërtimin e bashkëpunimit të ndërsjellë të Kryeprokurorit, Administratorit, Shefes së shkrimores dhe zëdhënësit për media. Ky menaxhim do të jetë i ndërtuar në planifikim, organizim, udhëheqje, koordinim dhe kontroll, të cilat janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Planifikimi përfshinë procesin e parashtrimit të qëllimeve dhe vendosjes se si më mirë arrihen ato. Organizimi përfshinë procesin e alokimit të burimeve njerëzore dhe jo njerëzore, ashtu që planet të mund të realizohen me sukses. Udhëheqja përfshinë procesin e ndikimit tek të tjerët që të përfshihen në sjellje pune të nevojshme për të arritur qëllimet e caktuara. Ndërsa kontrolli do të përfshij procesin e rregullimit të aktiviteteve organizative ashtu që performanca reale të jetë konform me standardet dhe qëllimet e pritura të institucionit.

- **Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?**

Deri tani me qëllim të sistemimit në mënyrë sa më drejtë në vendet e tyre të punës, në prokurorin të cilën aktualisht jam duke aplikuar, ka pasur një sistemim dhe ndarje të barabartë të punëve, duke mos krijuar pakënaqësi.

Për këtë do të kem bashkëpunim të mirë me administratorin dhe shefen e shkrimores, dhe në të ardhmen do të kujdesem që tek stafi administrativ të ketë ndarje të barabartë të punëve, të njëjtit të stimulohen për punë, që të mos krijohet ndonjë pakënaqësi eventuale dhe do të bëjë përpjekje që mes tyre të ketë sa më shumë bashkëpunim të ndërsjellë me qëllim të realizimit të detyrave të përcaktuara për secilin, duke i kushtuar një kujdes të veçantë në lidhje me futjen e të dhënave në sistemin elektronik të menaxhimit të lëndëve - SMIL. Në këtë mënyrë do t'u jepet edhe mundësia që eventualisht t'i shprehin pakënaqësitë e tyre rreth punës.

- **Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?**

Në lidhje me llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit, sikur deri më tani edhe në të ardhmen do të kem një kujdes të shtuar në respektimin e personalitetit dhe të drejtave të tyre. Gjithashtu në lidhje me punën dhe detyrat që duhet të kryhen nga stafi administrativ, do të mbahen takime individuale por edhe kolegji me në lidhje me çështje të ndryshme, për rritjen dhe përmirësimin e profesionalizmit dhe llogaridhënies në punë. Po ashtu në rastet eventuale të lëshimeve nga ana e tyre në lidhje me punën dhe detyrat që i kanë të caktuara, do të kërkoj llogaridhënie dhe përgjegjësi në kuptim të dispozitave ligjore adekuate.

- **Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

- **Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?**

Transparenca dhe llogaridhënia, do të mbetet objektiv i përhershëm i kësaj prokurorie,

ngase mjet i përshtatshëm për përmirësimin e imazhit dhe llogaridhënies, është edhe komunikimi në raste të caktuara me publikun. Besoj fuqishëm se besimi do të rritet duke promovuar punën dhe suksesin përmes komunikimit me publikun, duke inkurajuar sa më shumë daljen publike të prokurorëve lidhur me rastet e caktuara, përmes ofrimit të qasjes më të lehtë të qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile në informatat e këtij organi kushtetues. Do të vazhdojmë të avancojmë komunikimin e brendshëm dhe atë të jashtëm, ku do të angazhohemi që të kemi komunikim proaktiv me mediat dhe shoqërinë civile, si dhe koordinimin me institucionet e tjera të sistemi të drejtësisë të parapara për përmirësimin e komunikimit dhe rritjes së transparencës. Në vazhden e këtij aktiviteti duhet theksuar se edhe në hartimin e planeve të punës, do të kemi takime të rregullta me shoqërinë civile dhe media, si rrugë e transparencës por edhe marrjes së mendimeve eventuale lidhur me problematikat që ballafaqohet shoqëria. Si pjesë e planit të punës së kësaj prokurorie, transparenca me publikun do theksohet në tri pika kryesore:

- Komunikimi pro-aktiv me media;
- Menaxhimi i rasteve të jashtëzakonshme; dhe
- Bashkëpunimi i ngushtë me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe mediave.

Në kuadër të kësaj do të përfshihet inkurajimi i ankesave dhe sugjerimeve nga qytetarët dhe organizimi i takimeve për të dëgjuar shqetësimet e tyre. Do të sigurohemi në mbajtjen të informuar të Kryeprokurorit të shtetit, respektim të akteve nënligjore dhe gjatë komunikimit me publikun të sigurojmë balancimin në mes të ruajtjes së konfidencialitetit të hetimeve për rastet që janë duke u hetuar penalisht dhe interesit të përgjithshëm për informim të publikut.

- Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Në lidhje me punën sa më cilësore në prokurori fokusi do të jetë krijimi i ekipeve të përbashkëta me prokuror që merren me hetimin e veprave penale, sidomos për rastet e ndjeshme, ndërtimi i partneritetit dhe ngritja e besimit ndërinstucional. Përpjekja maksimale do të jetë në zhvillimin e raporteve sa më të mira në mes prokurorëve dhe stafit mbështetës, respektimin dhe ruajtje e pavarësisë së prokurorëve në kryerjen e detyrave të tyre ligjore, ashtu që në koordinim me secilin prokuror do të kujdesem që të kemi konsultime të vazhdueshme dhe bashkëpunim të ngushtë në lidhje me të gjitha çështjet. Kapacitetet ekzistuese do t'i forcoj duke bërë ndarjen e përgjegjësi, duke caktuar prokurorë me integritet të lartë si përgjegjës të departamentit të përgjithshëm, koordinator të fushave të lartcekura dhe do të formoj edhe kabinetin tim me qëllim që sigurimit të punës sa më cilësore, e cila do t'i shërbej menaxhimit më efikas dhe njëkohësisht kontrollimit dhe kualitetit të punës.

- Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Llogaridhënia mbetet një prej elementeve më të rëndësishme të punës së Prokurorit të Shtetit. Prokuroria Themelore në Pejë, do të mbetet e përkushtuar për të avancuar sistemin e mbikëqyrjes së punës së prokurorëve në forcimin e llogaridhënies për të

ngritur nivelin e cilësisë, profesionalizmit, sjelljes dhe efikasitetit me rastin menaxhimit dhe trajtimit të rasteve penale. Veprimet si Kryeprokuror për ta realizuar këtë objektivë do të jenë: zhvillimi i vizitave, diskutimet gjashtë mujore, vëzhgimi në seanca, propozimi për caktimin e shefit të departamentit të përgjithshëm, mbajtja e kolegjiemeve të rregullta, tryeza dhe konferenca në nivel më të gjerë për diskutim të çështjeve profesionale, mbikëqyrja për zbatimin e Kodit të Etikës dhe të tjera.

Në funksion të llogaridhënies sistematike, si Kryeprokuror do të kërkoj në baza të rregullta raporte me shkrim për të parë ecurinë e trajtimit të rasteve penale, praktikat e përdorura si dhe rezultatet e treguara. Mbikëqyrja e punës së secilit prokuror në veçanti do të bëhet së paku njëherë në gjashtë muaj, e cila do të jetë në funksion të inkurajimit dhe motivimit të tyre për punë efikase e deri te këshillat konkrete dhe rekomandimet në planifikimin dhe menaxhimin e lëndëve. Në kuadër të kësaj do të kërkoj që çdo prokuror të arrij nivelin e duhur të bashkëpunimit me institucione tjera dhe të ketë komunikim të duhur me gjyqtar, hetues, etj. Do të bëjë përpjekje maksimale që prokurorët të mos shoqërohen me persona që mund të dëmtojnë reputacionin dhe besimin e qytetarëve, të mos frekuentojnë vende ku ka persona të tillë, etj. Personalisht do të jem i qashtëm për prokuror, staf, zyrtar policor dhe të tjerë, e krejt kjo në funksion të kryerjes së detyrave në mënyrë sa më profesionale.

Në fund të këtij koncept dokumenti shtoj se *një vend me më pak krim dhe më pak korrupsion është më afër BE-së dhe vendeve të tjera*. Si epror, vendosmëria dhe guximi në situata komplekse është parakusht i suksesit. Ky koncept dokument synon të krijojë një prokurori më efikase, transparente dhe të besueshme, duke përmirësuar shërbimet dhe rritur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Implementimi i tij do të kërkoj angazhim dhe bashkëpunim nga të gjithë akterët e përfshirë.

Duke marr për bazë punën time në cilësi të prokurorit, përvojën në Departamentin e Përgjithshëm dhe Krimeve të Rënda, pastaj zv. Kryeprokuror, angazhimin tim maksimal të deritanishëm në menaxhimin, bashkëpunimin tim të ngushtë dhe ofrimin e mbështetjes profesionale për prokurorët në tri departamentet, ku me përgjegjësi, integritet dhe profesionalizëm konsideroi që kam arrit t'i kryej detyrat dhe përgjegjësit që më janë besuar, kam bindje që edhe më tutje do të kryej të gjitha punët dhe detyrat në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë.

Konceptdokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë sesa 10 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: 

Datë: 06.11.2024